

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 66/2023 “PËR ADMINISTRIMIN E OBJEKTEVE TË KONFISKUARA SI NDËRTIME PA LEJE, ME QËLLIM PËRDORIMIN E TYRE PËR INTERES PUBLIK APO STREHIM SOCIAL, SI DHE ZBUTJEN E PASOJAVE SOCIALE TË SHKAKTUARA”

Ministria e Brendshme fton qytetarë, organizata të shoqërisë civile, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik të projektligjit *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 66/2023 “Për administrimin e objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje, me qëllim përdorimin e tyre për interes publik apo strehim social, si dhe zbutjen e pasojave sociale të shkaktuara”*

Ministria e Brendshme mirëpret:

Komente të përgjithshme publike mbi përcaktimet e projektaktit, kryesisht mbi:

- efektet e mundshme në zbatimin praktik nga institucionet përkatëse;
- çdo aspekt që mund të ndihmojë në rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së projektaktit në praktikë.

Kontributet tuaja do të konsiderohen përgjatë procesit të përmirësimit të mëtejshëm të projektvendimit.

Ministria e Brendshme do të përmbledhë të gjitha sugjerimet dhe komentet tuaja dhe do të japë sqarime për mënyrën se si ato janë reflektuar në projektakt, edhe në rast se mendimet nuk reflektohen.

Kohëzgjatja e konsultimeve:

Konsultimi publik do të zgjasë 20 ditë pune, nga data 19 dhjetor 2025 deri më 16 janar 2026.

Si të përgjigjeni:

Mund të merrni pjesë në procesin e konsultimeve publike duke dërguar komente/kontribute për projektin:

- Duke plotësuar formularin online të Regjistrin Elektronik për projektligjit, në adresën elektronike: <http://www.konsultimipublik.gov.al>;
- Me email duke dërguar propozimet/sugjerimet tuaja në adresën e koordinаторit të konsultimit publik për Ministrinë e Brendshme, Sara Shameti, në adresën: Sara.Shameti@mb.gov.al

Kontakti:

Të dhënat e kontaktit të koordinorit përkatës për konsultime publike dhe/ose të ndonjë personi tjetër të cilit i drejtohen pyetjet:

Znj. Sara Shameti - Koordinatore e Konsultimit Publik, e-mail: Sara.Shameti@mb.gov.al

Datat dhe vendet e takimeve publike:

Projektligji u hartua nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Ministria e Punëve të Brendshme.

Sfondi i propozimit legjislativ:

Nevoja për hartimin e këtij projektligji buron nga një sërë problematikash të konstatuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 66/2023, të cilat kanë ndikuar negativisht në administrimin, zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara. Një nga çështjet kryesore ka qenë vendimmarrja e fragmentuar ndërmjet Komisionit të Objekteve të Konfiskuara, ministrisë përgjegjëse për administrimin e pronave shtetërore dhe Njësive të Zbatimit. Kjo ka sjellë vonesa të konsiderueshme në administrim, amortizim të objekteve dhe mungesë efikasiteti në procesin e përdorimit të tyre.

Efektet e pritshme nga zbatimi i këtij projektligji janë krijimi i procedurave më të shpejta, më të qarta dhe më të kontrollueshme, rritja e të ardhurave nga shitja dhe përdorimi publik i objekteve, shmangia e konflikteve ndërinstitutionale, forcimi i sigurisë juridike për pronarët dhe institucionet, si dhe garantimi i një niveli maksimal transparence për publikun.

Propozimet:

Ky projektligj synon modernizimin, qartësimin dhe unifikimin e procedurave për administrimin, zhvillimin, përdorimin dhe shitjen e objekteve të konfiskuara.

Ai kalon nga një model i shpërndarë kompetencash në një model të centralizuar dhe efikas pranë AAPSK.

Objektivat kryesore të cilat synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- a) forcimi i rolit të AAPSK-së si organ unik përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e objekteve të cilat kanë statusin “konfiskuar”;

- b) krijimi i Grupit të Punës si strukturë e përhershme teknike;
- c) garantimi i transparencës përmes Regjistrit Elektronik të Objekteve të Konfiskuara;
- d) thjeshtimi i procedurave të vlerësimit, zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit;
- e) sigurimi i financimit të qëndrueshëm përmes fondit të veçantë/të dedikuar për ndërtimet pa leje;
- f) mbrojtja e të drejtave të pronarëve të truallit dhe personave të tretë;
- g) rritja e efikasitetit dhe ulja e konflikteve ligjore

Pyetjet

Jeni të ftuar të jepni komentet dhe kontributet tuaja për të gjitha aspektet e projektligjit të propozuar. Për më tepër, ne kemi zgjedhur pyetjet e mëposhtme ku kontributi juaj do të jetë veçanërisht i vlefshëm, dhe të cilave mund t'i përgjigjeni duke plotësuar një pyetësor të shkurtër në internet.

- Si mendoni se mund të ndikojë ky projektligj në:

a. rritjen e efikasitetit, transparencës dhe unifikimit të procedurave për administrimin, zhvillimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara, përmes forcimit të rolit të AAPSK-së dhe krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm institucionalë?

b. mbrojtjen e interesit publik dhe të të drejtave të pronarëve dhe palëve të treta, në uljen e konflikteve ligjore dhe në rikthimin më të shpejtë dhe të qëndrueshëm të pasurive të konfiskuara në shërbim të komunitetit?